



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2943/13 prot.

Datë 08.01.2024

V E N D I M

Nr. 16/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1339/2023, datë 20.12.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

Ankimues: “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, me NUIS K81314023A, me adresë: Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3, Pasuri e Llojit Njësi Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210, Tiranë.

“AIDA CONSTRUCTION” SHPK, me NUIS M03116403L, me adresë: Rr. “BRIGADA XI SULMUESE”, L. APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kurbin me adresë: Lagjja Nr.3, Laç

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 20.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1339/2023, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
- 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK.*
- 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 5516/11 prot., datë 29.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2943/10 prot., datë 03.01.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Kurbin njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1339/2023, datë 20.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 5516/11 prot., datë 29.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2943/10 prot., datë 03.01.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Kurbin njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1339/2023, datë 20.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik si dhe verifikimeve në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar Vendimin Nr. 1339/2023, datë 20.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke anuluar procedurën e prokurimit në SPE në datën 29.12.2023.

II.2. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rast se autoriteti kontraktor Bashkia Kurbin, do të ripublikojë procedurën e mësipërme të prokurimit, duhet të paraqesë në KPP kopje të dokumentave të tenderit ku të pasqyrohet zbatimi i vendimit Nr. 1339/2023, datë 20.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

2. Në rast ripublikimi të procedurës së mësipërme të prokurimit, autoriteti kontraktor të paraqesë në KPP kopje të dokumentave të tenderit ku të pasqyrohet zbatimi i vendimit Nr. 1139/2023, datë 20.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiovent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

